



Skema e re e TVSH-së po dëmton prodhimin vendas të qumështit. U rritën ndjeshëm importet e bulmetit nga Serbia në 2021

Faqe 5



Garanton 20% të PBB-së së vendit, bujqësia mbetet më pak e kredituara

Faqe 5



Serrat e dëmtuara nga ngricat paralajmërojnë një valë inflacioni këtë vit

Faqe 5



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit shkurt 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 431
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

KASH ANALIZON SITUATËN E MEKANIZIMIT TË BUJQËSISË NË SHQIPËRI

RINOVIMI I MEKANIKËS BUJQËSORE, NEVOJË PËR TA BËRË FERMERIN KONKURRUES NË TREGUN RAJONAL

- Braktisja masive nga të rinjtë, e veprimtarisë dhe pronave në zonat rurale, zgjidhja: Programe afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për rritjen dhe intesifikimin e mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit në bujqësi dhe në të gjithë sektoret e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

- Fermerët në Shqipëri disponojnë 1.5 traktorë për 100 ha tokë bujqësore, Maqedonia e Veriut për të njëjtën sipërfaqe disponon 4 herë më shumë traktorë se Shqipëria, BE 6 herë më shumë, kurse Italia 8 herë më shumë. Zgjidhjet janë lehtësitë fiskale dhe financimi përmes granteve dhe kredive me kushte lehtësuese për importin e traktorëve, makinerive bujqësore, pajisjet për inovacionin dhe dixhitalizimin.

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Teknologjitë e zgjuara bujqësore dhe mundësi të reja pune në zonat rurale! Rasti i kompanisë Doni Fruits një histori suksesi



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

GRATË SIPËRMARRËSE NË BUJQËSI

Ivana, fermerja një model frymëzimi për çdo vajzë dhe grua



Faqe 2



TEMË E DITËS

Open Balkan për bujqësinë - Ekspertët: Përfitojmë vetëm nëse rritet buxheti nga qeveria

Open Balkan do ta ndihmojë bujqësinë shqiptare nëse qeveria shqiptare do të rrisë buxhetin për fermerët

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerët e kultivimit të mollës për periudhën e dimrit Fq.11
- Rritja e gjedhit dhe aspekte të riprodhimit të gjedhit Fq. 11 - 12
- Informacion për fermerët për agroteknologjitë e mbjelljes dhe kultivimit të BAM, shkurt 2022 Faqe 13
- UNDROP - Deklarata e OKB për të drejtat e fshatarëve dhe punëtorëve të tjerë të fshatit Fq.14

Çmimi i qumështit fut në krizë blegtorët e Lushnjës. Ankohen fermerët: E shesim me 40 lekë/ litër, grumbulluesit abuzojnë

Faqe 5

Kemi eliminuar profesionin e zooteknikut, ndikim në prodhimin e qumështit



Faqe 3

UBT KONTRIBUT NË ZHVILLIMIN RURAL

Universiteti Bujqësor i Tiranës zgjeron bashkëpunimin ndërkombëtar, Zingraf: Ky program doktoraturash hap shtegun për zhvillim



Faqe 4

RISI ALBANIA

Teknologjitë e zgjuara bujqësore dhe mundësi të reja pune në zonat rurale! Rasti i kompanisë Doni Fruits një histori sukcesi

Intervistë me Ejup Ahmetin, President i Kompanisë Doni Fruits

Doni Fruits Albania është një kompani lider në treg në sektorin e Agrokulturës. Tani ka shënuar edhe një hap tjetër të rëndësishëm në investimet që ka ndërmarrë në fushën e teknologjisë. Do të flasim me zotin Ejup Ahmetin për këtë risi dhe sa e ndihmon kjo fermerin vendas.

Si lindi kjo si ide bashkëpunimi me Vodafone Albania?

Kjo lindi pasi ishte një nevojë e jona e mëherëshme, pasi nuk kemi një centralizim të prodhimit dhe vizitat në ferma kishin kosto të larta, gjithashtu përmes teknologjisë ne kemi kontrollë dhe rezultate në kohë reale. Ne kemi mundësi të zhvillojmë produktin e mundësuar nga Vodafone në bazë të kërkesave tona. Ne

gjithashtu në qendrat e grumbullimit kemi instaluar pajisje të cilat masin parametrat kryesorë në mënyrë që produktet të jenë sa më cilësore dhe në rast se ka ndonjë anomalë në frigorifer ose qendër, personat përgjegjës të njoftohen përmes telefonit, kjo eliminon dëmet.

Ku konsiston zgjidhja e ofruar nga Vodafone Business dhe e implementuar në kompaninë Doni Fruits?

Gjithë kjo është një nga filimet e para të dixhitalizimit të kompanisë në sektorin e bu-

jqësisë. Ne kemi arritur të instalojmë pajisje smart në serra të cilat mundësojnë kontrollin

e lagështisë, temperaturës, rreziqet për sëmundje përmes monitoruesit 24 orë. Edhe nëse

në serra nuk ka punonjës regjistruhet çdo gjë dhe në mëngjes nxiret raporti. Kjo shërben për departamentin e prodhimit në mënyrë që të parandalojë rreziqet dhe të marrë masat.

A do e zgjeroni me tej këtë investim?

Ne kemi filluar një zinxhir shumë interesant i cili fillon implementimin në muajin mars, por jemi në diskutime të dixhitalizimit në çdo sektor të Doni Fruits, që detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit mos të jenë më me fjalë, por të jenë



Ivana, fermerja një model frymëzimi për çdo vajzë dhe grua

Gratë dhe vajzat rurale në Shqipëri përfaqësojnë pjesën më vitale të zhvillimit bujqësor dhe rural dhe kontributi i tyre

49-vjeçarja ka një lidhje të fortë me tokën dhe natyrën. Me punën dhe pasionin e saj, ajo ka arritur të jetë jo vetëm

Di si të kujdesem për bimët dhe kafshët, si të bëj plan biznesi, apo si të aplikoj për kredi e të gjej blerësit. Njohuria që kam marrë është e pafund, - thotë ajo.

Ivana është bashkuar që në vitin 2015, me grupin e fermerëve të mbështetur nga World Vision në komunitetin ku ajo jeton. Falë përkushtimit të vazhdueshëm, njohurive të fituara dhe rezultateve të arritura, nga një femerë e thjeshtë, u zgjodh drejtuese e grupit të fermerëve të fshatit Libonik, aty ku edhe jeton.

Ajo ka qenë pjesë e të gjitha trajnimeve të organizuara për bujqësinë e qëndrueshme, për zinxhirin e vlerave, si dhe për menaxhimin e burimeve natyrore në zonë. Tashmë është vetë Ivana që trajnon fermerët e tjerë të fshatit të saj për këto tema.

"Nuk ka asgjë që mund të më ndalë pasionin e punës. Jam kaq e lidhur me tokën sa nuk e shpjegoj dot. Në kohën kur e gjithë bota ndaloj, unë merrja mbesën me makinë dhe shkonim te tokat," - thotë Ivana, vrullin e së cilës, as pandemia e covid 19 nuk e frenoi dot.

Toka është burimi kryesor i të ardhurave për familjen e Ivanës, ndërsa bashkëshorti e ndihmon vazhdimisht në përpjekjet e saj. Duke hedhur pas krahëve paragjykimet, Ivana sytë i mban drejt së ardhmes.

"Nuk pendojmë për asgjë në jetë. Kam një natyrë që nuk më bëjnë përshtypje as fjalët, as barrierat gjinore, as vështirësitë financiare, as mungesa e njohurive, as kapacitetet. Ne mund të mësojmë që t'ia dalim. Kam hasur shumë shpesh në paragjykimet, por do vazhdoj përpara," - shprehet ajo.

Ivana vë fort theksin tek emancipimi dhe fuqizimi i gruas, si një shtyllë kyçe për avancimin e shoqërisë. Në përfundim të bisedës me të ajo ka një thirrje për të gjitha gratë dhe vajzat: Të guxojnë, të angazhohen dhe të ndërmarrin nisma. Ka vetëm një mënyrë për t'ia dalë: puna.

* Ivana është pjesë e 200 fermerëve dhe rrjetit të ngushtë prej 10 drejtuesish, me të cilët World Vision punon në zonën e Korçës dhe Maliqit.



është i paçmueshëm. Gruaja rurale kontribuon dhe investon në mirëqenien e familjes, jetës komunitare dhe më gjerë edhe pse ky kontribut shpesh është i pavlerësuar dhe i papaguar. Në të vërtetë, gruaja rurale është e varfër, dhe në krahasim me burrat në zonat rurale dhe gratë në ato urbane është më e varfër. Ajo ka akses të ulët në shërbime publike bazë, infrastruktura, tregje, teknologji dhe informacion. Ka akses shumë më të ulët në pronësi dhe menaxhimin e fermës; është më pak e arsimuar dhe e papërfaqësuar në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Gazeta "Agrobiznesi" në rubrikën adresuar fuqizimit të grave rurale, synon të sensibilizojë aktorët të linjës, për të rritur mbështetjen në agrazhimin e grave rurale në bujqësi, si faktor i rëndësishëm në jetën ekonomike sociale të vendit. Përmes opinionëve, historive të ndryshme synojmë të prekim tema që i shërbejnë fuqizimit të grave rurale, përmes angazhimit në sektorin e bujqësisë.

Për Ivanën, netët janë shumë të shkurtra. Drita e parë e mëngjesit e gjen atë në punë. Herë dhe ushqyer bagëtisë, e herë duke punuar tokën. Zgjidhet pa paguar, ndërsa mesnatën e pret shpesh ende në këmbë, duke mbyllur punët e shtëpisë.

Këto janë punë të përditshme për fermerin nga Maliqi që i sjellin gëzim dhe të ardhura të bollshme për familjen.

një femerë e suksesshme, por edhe një grua frymëzuese për të gjithë banorët e zonës ku jeton.

"Puna për mua është e shenjtë dhe nuk ka njeri në botë që të më mbushë mendjen për të kundërtën," - thotë Ivana, teksa na rrëfen rreth jetës së saj dhe përpjekjeve në bujqësi e blegtori.

Sot shijon frytet e punës, por rrugëtimi i saj nuk ka qenë i lehtë. Ivana ishte vetëm 3 vjeçe kur humbi të atin, që për të ishte shtylla e shtëpisë. Me mbështetjen e familjes dhe kurajon që e karakterizon, Ivana gjeti forcën të ecë përpara.

"Mamaja më thoshte shpesh që të mbaja vendin që më takonte si vajzë, si motër, por dy vëllezërit nuk më kanë detyruar kurrë që për shkak të tyre të tregohesha më e rezervuar apo më e tërhequr. Nëse do isha treguar e tërhequr nuk do kisha arritur gjërat që kam sot," - rrëfen ajo, ndërsa tregon se është përballur shpesh me sfida edhe për shkak të mentalitetit.

Ivana është kurajoze, luftarake dhe optimiste. Përgjatë viteve, ajo është marrë me rritjen e derrave, dhive apo lopëve, si dhe kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, si misër, fasule apo jonxhë.

Progresi në të drejtat e grave për pronësi, Krifca e ftuar nderi në Forumin Global 2022

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, ishte e ftuar nderi në panelin e nivelit të lartë të Komitetit të Sigurisë Ushqimore Globale (CFS), i cili ka vlerësuar progresin mbi barazinë gjinore për pronësinë e tokës në Shqipëri (SDG 5), sipas udhëzimit të FAO për Europën Juglindore. Komiteti shfaqti interes shumë të madh mbi ndryshimin që ka ndodhur në vend me barazinë gjinore.

Krifca u ftua në emër të Kryetarit të CFS Gabriel Ferrero, për të qenë pjesë e Panelit Ministror të Nivelit

Treguesi 5.a.2 fokusohet në masën në të cilën kuadri ligjor siguron të drejtat e barabarta të grave për pronësinë e tokës. Qeveria Shqiptare ka pohuar angazhimin e saj për të njohur, respektuar dhe mbrojtur të drejtat e zotëruesve të ligjshëm. Barazia gjinore në aksesin, pronësinë dhe kontrollin e tokës është thelbësore për të nxitur gjithëpërfshirjen, për të reduktuar varfërinë dhe për të rritur kapacitetin produktiv dhe sipërmarrës të grave, për të siguruar rritje dhe zhvillim ekonomik të barabartë dhe të qëndrueshëm. Ajo është ar-

të grave (përfshirë të drejtat e tokës) në lidhje me mbrojtjen e pronës ndërsa ligji i ri "Për Kadastrën Shtetërore" synonte rregullimin e elementeve të barazisë gjinore në lidhje me regjistrimin e pronës. Bashkëpunimi më i mirë ndërmjet noterëve publikë dhe zyrate të regjistrimit të tokës kontribuoi në reduktimin e praktikave tradicionale diskriminuese me bazë gjinore në zotërimin e tokës. Në bashkëpunim të ngushtë me FAO dhe GIZ, institucionet shqiptare u njohën me metodologjinë e FAO-s për mbledhjen e të dhënave rreth SDG 5.a.2. Është testuar dhe pilotuar pyetësi përkatës për mbledhjen e të dhënave të FAO-s. Rezultatet e vlerësimit ligjor treguan progres të mirë.

Edhe pse qeveria shqiptare ka bërë përpjekje të mëdha për të përmirësuar mjedisin e politikave në lidhje me barazinë gjinore në të drejtat e tokës, monitorimi i këtij treguesi është shumë sfidues. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të inkurajuar regjistrimin e përbashkët të tokës përmes stimujve ekonomikë në rastin e çiftëve të pamartuara dhe për të rritur ndërgjegjësimin e grave për të drejtat e tyre për tokën. Në kuadër të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të harmonizojë ndërhyrjet e saj me ministritë dhe palët e tjera të interesit për të arritur suksesin në arritjen e vizionit të vendit për vitin 2030, duke përfshirë zhvillimin e mjeteve dhe mekanizmave konkretë për të siguruar monitorimin e SDG. 5.a.

Do të doja t'ju falënderoja për vëmendjen tuaj dhe ju uroj një forum shumë produktiv.



të Lartë në Forumin Global 2022 për Ushqimin dhe Bujqësinë (GFFA). GFFA është një konferencë ndërkombëtare mbi çështjet qendrore me rëndësi jetike për politikat globale bujqësore dhe ushqimore. Mbahet çdo vit në Berlin, organizuar nga Ministria Federale e Ushqimit dhe Bujqësisë e Gjermanisë. Më poshtë gjeni fjalën e ministres Krifca:

Jam e kënaqur dhe shumë e nderuar që jam ftuar në Forumin Global për Ushqimin dhe Bujqësinë 2022 për të prezantuar progresin e Shqipërisë në SDG 5.a bazuar në udhëzimet e FAO-s për forcimin e barazisë gjinore në regjistrimin e tokës në Evropën Juglindore.

tikuluar mirë në dokumente të ndryshme strategjike, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim (2014-2020) dhe Strategjinë e re Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030).

Përmirësimet e fundit të legjisllacionit vendas, rregulloret dhe procedurave administrative kontribuan për të kapërcyer boshllëqet e zbatimit të lidhura me gjininë midis ligjit dhe praktikës në fazat e ndryshme të procesit të regjistrimit të tokës, duke i shndërruar të drejtat ligjore të grave në regjistrim të pronës së përbashkët. Pra, ligji i ri "Për Noterinë" synonte garantimin e të drejtave pronësore

KASH ANALIZON SITUATËN E MEKANIZIMIT TË BUJQËSISË NË SHQIPËRI

RINOVIMI I MEKANIKËS BUJQËSORE, NEVOJË PËR TA BËRË FERMERIN KONKURRUES NË TREGUN RAJONAL

- Braktisja masive nga të rinjtë, e veprimtarisë dhe pronave në zonat rurale, zgjidhja: Programe afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për rritjen dhe intensifikimin e mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit në bujqësi dhe në të gjithë sektoret e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.
- Fermerët në Shqipëri disponojnë 1.5 traktorë për 100 ha tokë bujqësore, Maqedonia e Veriut për të njëjtën sipërfaqe disponon 4 herë më shumë traktorë se Shqipëria, BE 6 herë më shumë, kurse Italia 8 herë më shumë. Zgjidhjet janë lehtësitë fiskale dhe financimi përmes granteve dhe kredive me kushte lehtësuese për importin e traktorëve, makinerive bujqësore, pajisjet për inovacionin dhe dixhitalizimin.

Bujqësia është një veprimtari ekonomike e rëndësishme për Shqipërinë për shkak se përbën alternativën kryesore të zënies me punë të njerëzve në zonat rurale si dhe përbën mbi 18% të prodhimit të brendshëm bruto. Toka bujqësore mesatare për frymë (më pak se një hektar) përbën një nga më të voglat në Evropë. Bujqësia në Shqipëri ka një nivel të ulët mekanizimi dhe konsiderohet si bujqësi mbijetese. Sipas studimeve në fushën e mekanikës bujqësore Shqipëria ka mesatarisht 1.24 traktorë për 100 ha tokë të punuar, ndërsa Maqedonia 6 traktorë për 100 ha tokë të punuar, Greqia ka 6.6 traktorë për 100 ha tokë të punuar, Italia 13.2 traktorë për 100 ha tokë të punuar dhe së fundmi, mesatarisht shtetet e Bashkimit Evropian kanë 8.1 traktorë për 100 ha tokë të punuar. Gjithashtu, tregues të përafërt shfaqen edhe në përdorimin e makinerive bujqësore për traktor. Kështu, Shqipëria

përdor 1.5 - 2 makineri të ndryshme bujqësore për çdo traktor, vendet e rajonit përdorin mesatarisht 5 - 7 të tilla, ndërsa vendet e Bashkimit Evropian 13 makineri bujqësore për traktor.

Mekanizimi i fermave ka një rol të rëndësishëm në ndikimin e ndryshimeve thelbësore si inovacioni teknologjik, ndryshime në faktorin kosto si dhe ndryshime institucionale të tillë si të drejtat për përdorimin e tokës. Në rastet kur mekanizimi i fermave është ekonomikisht i arsyeshëm, mungesa e mekanikës bujqësore përbën një kufizim në burimet e fermës dhe rrjedhimisht pengon rritjen e prodhimit dhe prodhueshmërisë¹.

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (këtej e tutje KASH), Enti Kombëtar Rural (këtej e tutje E.K.R.) ka si qëllim të nxisë rritjen e prodhimit bujqësor, përmirësimin e jetës në zonat rurale dhe uljen e nivelit të varfërisë nëpërmjet mekanizimit të qëndrueshëm të fermave

bujqësore. Në përmbushje të këtij qëllimi, ka identifikuar si faktorë pengues në rritjen e mekanizimit të fermave në Shqipëri, shkaqet e mëposhtme:

1. Kosto e lartë e përdorimit të mekanikës bujqësore në fermë
 2. Eficienca e ulët e mekanikës ekzistuese bujqësore
 3. Sipërfaqen e vogël të fermave
- KASH dhe E.K.R. ka analizuar shkaqet e mësipërme dhe në vijim, propozon zgjidhjet e mëposhtme të cilat parashikojnë ndryshime legjislative me qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për përdorimin e mekanikës bujqësore nga fermerët shqiptarë.

Kosto e lartë e përdorimit të mekanikës bujqësore në fermë

Situata aktuale

Kostoja kryesore e përdorimit të mekanikës bujqësore është çmimi i karburantit (pra, i naftës dhe i nënprodukteve të saj). Në

Shqipëri, çmimi i karburantit që përdoret nga mjetet bujqësore është i njëjtë me çmimin e karburantit që përdoren nga mjetet e tjera të motorizuara. Gjatë 10 vjeçarit të fundit çmimi i karburantit është rritur dhe tendenca është që rritja do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Nevojat e tregut të hidrokarbureve në Shqipëri përmbushen kryesisht nga nafta e importuar e cila parashikohet të kalojë çmimin me pakicë 2 \$ për litër. Sipas llogaritjeve të kryera nga ekspertët e KASH dhe E.K.R. fermerët përdorin mesatarisht 35 deri në 40 mijë tonë naftë në një vit bujqësor, ose e konvertuar në litra llogaritet rreth 50 milion litra. Kjo sasi e vlerësuar me 1.8 \$ për litër që është aktualisht çmimi i blerjes me pakicë nga fermerët dhe subjektet e tjera që përdorin mekanikën bujqësore, kushton 90 milion \$ në një vit bujqësor. Pra, kosto e drejtpërdrejtë e fermerëve dhe e subjekteve të tjerë për përdorimin e mekanikës bujqë-

sore në Shqipëri është 90 milion \$ në një vit bujqësor. Për më tej, në rastin e pritshëm të rritjes së çmimit të naftës në 2 \$ për litër, kostoja e fermerëve për përdorimin e mekanikës bujqësore, në kushtet aktuale, do t'i kalojë 100 milion \$. Kostoja e rritur e përdorimit të mekanikës bujqësore do të nxisë rritjen e kostonë së prodhimit dhe rrjedhimisht do të ndikojë në përkeqësimin e kushteve ekonomike të banorëve në zonat rurale si dhe do të nxisë lëniën e papunuar të tokës bujqësore.

Zgjidhja e propozuar

Me qëllim parandalimin e pasojave negative që sjell rritja e kostonë së përdorimit të mekanikës bujqësore si dhe nga ana tjetër, krijimin e një mjedisi rregullator që lehtëson përdorimin e saj KASH dhe E.K.R. propozon krijimin e një skeme të furnizimit me karburant të fermerëve e cila do të mbështetet tek përdorimi i naftës së prodhuar në

Republikën e Shqipërisë.

Shqipëria, si rezultat i rezervave të mjaftueshme të hidrokarbureve, me anë të prodhimit vendas mundet të përmbushë të gjithë nevojën e fermerëve dhe përfituesve të tjerë në zonat rurale për furnizimin e tyre me karburant. Gjithashtu, aktualisht në vend ka kapacitete përpunuese të gatshme e të mjaftueshme për të plotësuar në kohë, në sasi e cilësi nevojat e fermerëve dhe të përdoruesve të tjerë të mekanikës bujqësore.

KASH dhe E.K.R. ka vlerësuar se kosto e naftës së prodhuar në vend, duke përfshirë edhe koston e përpunimit, llogaritet në rreth 400 \$/ton. Në një analizë krahasuese, kosto e naftës së importuar është tre herë më e madhe se sa kosto e naftës së vendit.

¹ Banka Botërore, Mekanizimi i fermave: Një sfidë e re për bujqësinë në vendet e Evropës dhe të Azisë Qendrore me të ardhura të ulëta dhe të mesme (2010)

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Situata me bujqësinë, Tarelli: Janë rritur eksportet, fermerët po orientohen drejt kulturave me vlerë

Për drejtorin e politikave bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Irfan Tarelli situata e bujqësisë në vendin tonë është pozitive, duke cituar të dhëna nga doganat. Sipas Tarellit, eksportet janë rritur me mbi 15% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që vlerësoi dhe strategjinë e ndjekur në drejtim të kultivimit të kulturave me

vlerë të lartë.

"Eksportet në total nga të dhënat e doganave, në krahasim me 2022, në 2021 kemi 15.6% rritje të eksporteve në vlerë, në bujqësi, në agro-përpunim dhe peshkim. Kjo nuk ndodh rastësisht. Kemi një përmirësim të raportit import-eksport. Brenda nëndegëve ka dinamika të ndryshme. Ne nuk

kemi avantazh të prodhimit të drithërave, nuk mund t'i inkurajojmë fermerët për këtë gjë. Ka mjaft produkte me të cilat kemi bilanc pozitiv, por ka dhe negativ. Fermerët tanë po orientohen drejt kulturave me vlerë të lartë dhe po shfrytëzojmë hershmërinë. Ne po dalim në eksport", tha Tarelli.

Kemi eliminuar profesionin e zooteknikut, ndikim në prodhimin e qumështit

Ervin Resuli, ekspert për bujqësinë, u shpreh në A2 Business mbrëmjen e së mërkurës se në Shqipëri ka

gati përgjysmim të numrit të krerëve në këto 4 vite.

Nuk ka interes në aspektin ekonomik për të inves-

se mungesa e zooteknikëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në mungesën e qumështit.

"Në muajin dhjetor ne e kemi analizuar këtë situatë, ku u mblodhën, fermerë e blegtorë. Ky është një kompleks, nuk janë vetëm 2 apo 3 shkaqe. Nuk është vetëm subvencionimi. Në radhë të parë ne evidentuam mënyrën e kooperimit. Kështu të vetmuar siç kemi qenë dhe me këtë madhësi ferme që kemi nuk mund të përballojmë rajonin. Ne kemi eliminuar nga blegtoria profesionin e zooteknikut.

Rënia e prodhimit të qumështit lidhet drejtpërdrejtë sepse nuk kemi zooteknik. Zootekniku është ai që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit. Një element tjetër është mungesa e kullotave, ku kemi mungesë investimesh. Ne kemi një çrregullim total të kullotave. Njëkohësisht duhen ndryshuar edhe subvencionet", tha Rrapaj.



një rënie drastike të numrit të gjedhëve. Ai theksoi se nuk ka interes në aspektin ekonomik për të investuar.

"Ka një rënie drastike të numrit të gjedhëve dhe jo vetëm te fermet e vogla familjare, por edhe te fermet e mëdha, përjashtoi këtu fermet shumë të mëdha. Ky është një problem shumë i madh pasi kemi

tuar, pasi vetëm në vitin 2021, drithërat, imputet bujqësore kanë shkuar në nivele maksimale dhe skemat mbështetëse janë po ato që kanë qenë", u shpreh Ervin Resuli, ekspert për bujqësinë.

Sa i përket mungesës së qumështit, Agim Rrapaj, kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, u shpreh



UBT KONTRIBUT NE ZHVILLIMIN RURAL

Rama: Bursa doktorature në Evropë për profesionistët e rinj në bujqësi

Kryeministri Edi Rama deklaroi të premten se "sot është ditë e bukur për Universitetin Bujqësor të Tiranës, pasi falë bashkëpunimit me qeverinë gjermane edhe kontributin e agjencisë gjermane të ndihmës, sot hapet një proces doktoraturash i një cilësie të garantuar".

I pranishëm në kuadër të prezantimit të programit të doktoraturave në bujqësi, mundësuar nga projekti "Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural", një financim nga qeveria gjermane që zbatohet nga GIZ, në mjediset e Universitetit Bujqësor të Tiranës, Kryeministri Rama u ndal në bashkëpunimin shumë të ngushtë mes qeverisë dhe Universitetit Bujqësor.

Kreu i qeverisë e konsideroi këtë bashkëpunim shumë të dobishëm në mbështetje të një sektori jetik, i cili tha Rama "është në një fazë delikate të jetës së vetë për shkak të domosdoshmërisë për sa më shumë dije dhe inovacion".

"Sot është një ditë e veçantë për universitetin, sepse hapet një proces doktoraturash i një cilësie të garantuar. Do ju jepet mundësia 30 individëve me vlerë të spikatur në rrugën e tyre, që të zhvillojnë një doktoraturë e cila të ketë vlerë të universiteteve më të mira të fushës, në Gjermani, apo vende të tjera të BE-së. Kjo është rruga jonë, ku duhet të ecim dhe ky është modeli që ne duhet të shtrijmë në të gjithë sistemin për doktoraturat", nënvizoi Rama.

Kryeministri Rama theksoi se "ne nuk duhet të japim doktoratura lokale. Ne nuk duhet të kemi, në të ardhmen tonë jo shumë të largët, universitete lokale. Ne duhet të kemi një sistem të lartë arsimor të ndërkombëtarizuar dhe një botë universitare të integruar në sistemin evropian".


Gjithashtu, tha Rama, në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, zgjerimi i partneriteteve me universitetet jashtë vendit janë në fokus të Qeverisë, si nisma të domosdoshme që synojnë, hapjen ndaj përvojave të reja evropiane e më

gjerë.

"Më vjen shumë mirë që ndodh kjo në këtë universitet dhe që ky universitet bëhet një shembull që ne do të bëjmë çmos të rrezatojmë në sistemin tonë arsi-

versitetit të Vjenës", tha Rama.

Kryeministri Rama bëri të ditur se, "sa i përket rritjes së interesit për t'u regjistruar kjo është rruga, ky është sektori i të ardhmes, teknologjia mund të



mor, sepse ky universitet është i rëndësishëm për këtë vend dhe të ardhmen e këtij vendi", tha Rama.

Kryeministri Rama u shpreh se, "ka ndodhur një ndryshim në këtë universitet në krahasim me vizitën e parë që kam bërë këtu, pasi më parë duhet të gjeje derën e universitetit duke pyetur, sepse ishte një kaos, rrëmujë dhe turp i paparë. Pashë edhe godinën e re që po merr formë paralelisht edhe me godinat e tjera, që do të jetë një nga kampuset më të bukur të rajonit, jo të Shqipërisë dhe ku do ndërthuren edhe aktivitetet të tjera, por mbetet një pjesë që ka të bëjë me kushtet fizike, ndërkohë që pjesa më e vështirë ishte pjesa që ka të bëjë me zhvillimin e mendimit akademik dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies".

"Më vjen shumë mirë që ne sot jemi në një fazë të avancuar që po strukturohet me një nga universitetet më të vjetër e më të mirë të botës të zhvillimit rural, me Universitetin e Vjenës, me të cilin synimi ynë i përbashkët me rektorin është që të ndërtojmë një marrëdhënie që hap pas hapi të kthehet në një sinergji të plotë. Universiteti Bujqësor i Tiranës të jetë një derë tjetër e Universitetit të Vjenës dhe të gjithë studentët që do të vijnë këtu të mbarojnë studimet me një diplomë të Uni-

bëjë gjithçka, por nuk prodhon dot ushqime, kompjuterat nuk prodhojnë dot bukë, perime, fruta mish etj.".

Përzgjedhja e 30 fituesve, pas hapjes së thirrjes në fund të janarit, do të bëhet nga një komision i posaçëm në bazë të kriterëve të dakordësuar ndërmjet GIZ, Universitetit Bujqësor dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Startimi i programit do të bëhet në fillim të marsit dhe ka si qëllim përfshirjen e barabartë të grave dhe burrave nga të gjitha zonat e Shqipërisë, si një nga përparësitë e qeverisë për përfshirjen e sa më shumë grave dhe vajzave në sektorin bujqësor.

Pas përfundimit me sukses, studiuesit e kanë të përcaktuar rikthimin dhe qëndrimin në Shqipëri, për të paktën 5 vjet, në mënyrë që përvoja e fituar të reflektohet sa më shumë në vendin tonë.

Ky program synon përfshirjen e sa më shumë të rinjve në sektorin bujqësor dhe rural, kualifikimin e mëtijshëm të studentëve ekselentë dhe profesionistëve të rinj, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit, sektorit publik dhe privat në Shqipëri si dhe integrimin e njohurive teorike e praktike, me shembujt më të mirë të Bashkimit Evropian.

ky program synon përfshirjen e sa më shumë të rinjve në sektorin bujqësor dhe rural, kualifikimin e mëtijshëm të studentëve ekselentë dhe profesionistëve të rinj, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit, sektorit publik dhe privat në Shqipëri si dhe integrimin e njohurive teorike e praktike, me shembujt më të mirë të Bashkimit Evropian.

cionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Pra, kontrollet në dogana nuk do të bëhen më nga veterineret por nga inspektorët e AKU. Nga ana tjetër, për shtetet të cilat kanë marrëveshje me vendin tonë, do të zbatohen marrëveshjet përkatëse, sa i takon kontrolleve, shpenzimeve për marrjen e mostrave dhe kryejnë e analizave laboratorike, apo tarifave që aplikohen për këtë qëllim.

Universiteti Bujqësor i Tiranës zgjeron bashkëpunimin ndërkombëtar

UBT në bashkëpunim me qeverinë gjermane ka marrë një program Doktorature në Bujqësi, Mjedis, Bioteknologji, Agrobiznes dhe Mjekësi Veterinare, i cili synon kualifikimin e mëtijshëm të studentëve ekselentë dhe profesionistëve të rinj, duke shfrytëzuar ekselencën e Bashkimit Evropian.

Në ambientet e këtij universiteti, u zhvillua sot prezantimi i këtij bashkëpunimi të rëndësishëm, ku morri pjesë Kryeministri Edi Rama, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit

së Ambasadës gjermane një grup prej 15 pedagogësh kanë ndjekur kursin e gjuhës gjermane. Çdo doktorant i zgjedhur do të qëndrojë në fazën e parë të programit, rreth 6 muaj në një nga universitetet e huaja, ku do të përqendrohet në fillimin e punës shkencore.

"Ambicia jonë është që të gjithë asistentë lektorët e rinj të UBT-së, rreth 40 vetë të kryejnë të gjitha proceset e doktoraturës në universitetet e huaja, duke përbushur kështu misionin për ndërkombëtarizimin e ofertës akademike dhe

isë gjermane. Synimi është krijimi i një grup ekspertësh të aftë për të kontribuar në hartimin e politikave zhvillimore në bujqësi dhe hartimin e përgjigjeve për të gjitha shqetësimet që ka sektori i bujqësisë apo blegtorisë. UBT është partner i rëndësishëm në zhvillimin rural të vendit", tha Krifca.

Ndërkombëtarizimi, Kushi: UBT zgjedhje e parë e studentëve

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Evis Kushi në përshëndetjen mbajtur me këtë rast, tha se "ndërkombëtarizimi i universitetit është një nga arritjet më të rëndësishme të UBT-së, i cili pak ditë më parë kremtoi edhe 70-vjetorin e krijimit të tij".

"UBT, ka bërë një progres të konsiderueshëm teksa solli në vëmendje marrëveshjet që ka nënshkruar UBT me Universitetin e Vjenës, Miçiganit, por edhe universitete të tjera evropiane", tha Kushi.

Ajo shprehu përgëzime për arritjet e UBT-së, teksa theksoi se sfida është që këto marrëveshje të kthehen në programe konkrete studimi të përbashkëta dhe për këtë duhet të punojmë të gjithë bashkë.

"Ne do të bëjmë përpjekje që ta shtyjmë këtë proces përpara dhe sa më shpejt studentët tanë këtu në Shqipëri të kenë në duar diploma që kanë të njëjtën vlerë si diplomat që kanë studentët në vendet evropiane", theksoi Kushi.

Ministrja bëri të ditur se, UBT së shpejti do të ketë një nga kampuset më moderne, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë rajonin. 10 milionë euro nga programi i Rindërtimit, 8 godina me standarde nga më bashkëkohoret do të shërbejnë si një qendër multifunkionale ku ofrohen shumë shërbime.

"Hapja e programeve të doktoraturës pas disa viteve ndërprerjeje, sipas modeleve më mira është një lajm i mirë. UBT sot është më avangarda ndër universitete në Shqipëri, pasi diplomat e UBT-së njihen edhe jashtë vendit, por sfida sot është që UBT të jetë zgjedhja e parë jo vetëm nga studentët vendas por edhe nga studentët e Rajonit dhe Evropës dhe për të garantuar këtë kërkohet vëmendje tek cilësia", tha Kushi.

Ministrja vuri në dukje se, ne do të jemi rigorozë në zbatimin e standardeve në UBT, teksa sfidë mbetet thithja e studentëve. Përmes bursave apo kostove të ulura dhe lidhje me tregun e punës do të jenë disa nga mekanizmat për nxitjen e të rinjve që të studiojnë në këtë universitet.



Rural, ministrja e Arsimit dhe Sportit, ambasadori gjerman, profesorë dhe studentë të këtij universiteti.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Fatbardh Sallaku, në fjalën e mbajtur me këtë rast tha se, "aktiviteti i sotëm është në koherencë me çështjet që parashtron bujqësia dhe specififikisht në atë të nevojës për rritjen e kapaciteteve humane, aq të rëndësishëm për implementimin e politikave zhvillimore në bujqësi".

Sipas tij, aktiviteti i sotëm që lidhet me hapjen e thirrjes për aplikime për studime doktorature në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore etj., është në koherencë me këtë filozofi dhe i shërben implementimit të politikave bujqësore.

"Përmes këtij programi Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si një nga përfitues e këtij projekti ka një interes të drejtpërdrejtë, pasi të gjitha tematikat e dakordësuar dhe të përkthyer në projekte specifike të tilla si: efikasiteti i fermës, roli i kooperimit etj, anë në interes të politikave zhvillimore të MBZHR, sidomos në kushtet e përgatitjes së negociatave me BE", tha Sallaku.

Sallaku vuri në dukje se, kandidatët që do të bëhen pjesë e këtyre programeve do të kenë mundësinë të kontribuojnë në MBZHR dhe nëpërmjet eksperiencës së fituar nga programi gjerman dhe pedagogët e huaj, do të kenë mundësi maksimale të përfitojnë nga ky program.

Gjatë kësaj periudhe, theksoi Rektori i UBT-së, janë vendosur kontakte me universitetet pritëse në Gjermani, Austri dhe Itali dhe falë mbështetjes

shkencore të UBT-së", tha Sallaku.

Ai theksoi se, UBT po përpiket ta kthejë në avantazh këtë bashkëpunim për fermerët dhe zhvillimin e bujqësisë, teksa bëri të ditur se, UBT po implementon disa projekte të mëdha si krijimi i fermës didaktike, parkun agroturistik, ngritjen e parcelës didaktike ku të eksperimentohen elementët e bujqësisë precize smart, etj., të gjitha në funksion të zhvillimit të bujqësisë sipas standardeve më të mira bashkëkohore.

Krifca: UBT, partner i rëndësishëm në zhvillimin rural të vendit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca, tha se MBZHR e ka të domosdoshme bashkëpunimin me UBT dhe kjo tashmë është jetësuar edhe në disa drejtime.

"Kemi 5 përfaqësues të UBT-së në Bordin e AKU-së, të cilët do të japin një mendim shkencor këtij institucioni në fushën e sigurisë ushqimore. Ndërsa ngritja e fermës didaktike është modeli më bashkëkohor me kontribut në zhvillimin e bujqësisë", tha Krifca.

Studentët, pedagogët e UBT janë zëri i këshillimit shkencor në bujqësi, propozuesit e ideve novatore, në teknologji dhe zhvillimin e të gjithë vendit.

"Jemi sot këtu për të gjitha ata që do të fillojnë ciklin e doktoraturës dhe që me punën e tyre do të përmirësojnë punën shkencore në bujqësi. Riaktivizimi i programit të doktoraturës është një lajm i mirë për më tepër kur ky program vjen nën partneritetin e qever-

Lehtësohet tregtia e ushqimeve me rajonin - Ligji/ Rishikohen kontrollet doganore, AKU merr më shumë përgjegjësi!

Ndërsa volumi i shkëmbimeve tregtare në fushën e ushqimit midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit ka ardhur në rritje, ende ka pengesa të konsiderueshme sa i takon kontrolleve doganore. Për këtë arsye, një ligj i miratuar pak ditë më parë në Kuvend, synon lehtësimin e procedurave të kontrollit nga autoritetet përgjegjëse për sigurinë ushqimore dhe autoritetet doganore, në mënyrë që levizja e produkteve të arrijë tek konsumatori në

kohe sa më të shpejtë.

Kështu, ndryshimet në ligjin "Për ushqimin", kanë për qëllim të lehtësojnë aktivitetin e bizneseve që kryejnë veprimtari ekonomike në import-eksport, duke hequr konceptin e veterinerit në pikat e kufitare, dhe duke lejuar që kontrolli i perputhshmerise se dokumentacionit shoqerues të ngarkesave të importuara, me legjislacionin shqiptar, të kryhet në pikat e inspektimit kufitar nga inspektorët e insititu-

POLITIKA FISKALE

Garanton 20% të PBB-së së vendit, bujqësia mbetet më pak e kredituara. Bankat tregojnë arsye të hezitimit për t'i dhënë hua fermerëve

Bujqësia është sektori që garanton rreth 20% të ekonomisë së vendit si dhe punëson 1/3 e shqiptarëve, ndërkohë që nga ana tjetër mbetet një sektor i pa-formalizuar dhe i nën-financuar. Edhe pse kreditimi i ekonomisë ndër vite ka arritur në rritje, tek bujqësia ka ndodhur krejt e kundërta pasi ka pësuar rënie, pasi akseset në financë i fermerëve është i vështirë.

**• 1 mld lekë në dispozicion për kreditë në bujqësi, kushtet vendosen në shkurt!
Biznesi: Interes jo më i lartë se 3%! Agrobiznesi: Këstet të paguhën pas shitjes së prodhimit**

Të dhënat e 5 viteve të fundit flasin për kreditim në nivele minimale për këtë sektor. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë kredia e re e dhënë në 11 muajt e vitit të kaluar ishte në vlerën e 2.02 miliardë lekë, duke u ulur me 6.2% në raport me vitin 2020.

Në total për vitin 2020 për bujqësinë kredia e re ishte 2 miliardë e 497 milionë lekë. Ndërkohë në vitin 2019 kredia e re e dhënë për bujqësinë ishte 2.1 miliardë lekë, rreth 2-fish më pak se në 2018 kur bankat kishin dhënë 4 miliardë e 167 milionë lekë.

KREDIA E RE E DHËNË PËR BIZNESIN	
Viti 2017	3.086 mld lekë
Viti 2018	4.167 mld lekë
Viti 2019	2.108 mld lekë
Viti 2020	2.497 mld lekë
11 muaj të 2021	2.024 mld lekë

Sipas Bankës së Shqipërisë aktualisht, sektori bujqësor përfiton vetëm 1.7% të financimit që bankat ofrojnë për biznesin privat, dhe mbetet shumë larg nevojave reale të sektorit.

Shkaqet kryesore sipas bankave për këtë nivel kaq të ulët të kreditimit janë të shumta, duke nisur nga informalite-



ti, mungesa e kolateralit, problemet e pronësisë, apo varësia kushtet e motit. Probleme këto që u përmendën edhe nga Bledar Shella, kryetar i shoqatës së Bankave, gjatë prezantimit të kredisë sovraane prej 1 miliardë lekësh në 26 janar.

Por shkak tjetër është edhe mungesa e sigurimit të këtij sektor. Mungesa e sigurimit të fermerëve e ekspozon edhe më

shumë këtë sektor ndaj rreziqeve të kushte atmosferike, qofshin përmbytje, ngrica apo thatësira. Dhe në mungesë të një investimi të sigurt, edhe bankat hezitojnë të japin kredinë për shkak se nuk janë të bindura që huaja do tu kthehet sipas afateve.

Serrat e dëmtuara nga ngricat paralajmërojnë një valë inflacioni këtë vit

Serrat e sapombjella me domate, kastravecë dhe patëllxhanë në zonat më prodhuese të vendit lajmërojnë për një verë të "acartë" në çmime.

Rënia e sipërfaqeve të mbjella në sera dhe në fushë, për shkak të çmimeve të larta të inputeve bujqësore të kombinuara me ndikimet klimatike (përmbytjet e nëntorit) dhe ngricat e fundit, duket se do të sjellin më pak prodhime vendase në treg e për rrjedhojë, çmime më të larta.

Përvoja ka treguar se çmimet në tregun vendas pësojnë luhajtje të fortë në varësi të furnizimeve nga prodhimet vendase dhe çmimet e tyre. Në 10 vitet e fundit ka plot shembuj ku rënia e sipërfaqeve të mbjella është reflektuar me çmime të larta.

Shporta e konsumit të familjeve shqiptare ka aq shumë varësi nga ushqimet, sidomos frutat dhe perimet, sa luhajtjet në çmimin e një artikulli të vetëm mund të çëkuilibrojnë një nga treguesit më të rëndësishëm makroekonomikë, inflacionin. Sipas INSTAT, grupi "ushqime, pije joalkoolike dhe duhan" zë 42% të totalit të shpenzimeve në një familje, nga 13% që është mesatarja europiane dhe 30-35% në vendet e tjera të rajonit.

Brishtësia e prodhimit vendas në disa kultura sidomos frutat dhe zarzavatet shënon goditje ekstreme në nivelin e përgjithshëm të çmimeve.

Për shembull në vitin 2019, zona e Korçës mbolli më pak patate për arsye se një vit më parë, fermerët nuk kishin arritur të shisnin prodhimet e tyre, duke akumuluar humbje, teksa prodhimet u kalbën. Si rrjedhojë duke menduar se situata do të përsëritej me 2019 fermerët braktisën kulturën e patates, duke bërë që çmimi i saj në tregje të dyfishohej në një vit.

Duke qenë se patatja bashkë me qepën konsumohen gjerësisht, ajo ndikoi në rritjen e inflacionit gjatë vitit 2019. Në janarin e vitit 2019, çmimi i perimeve dhe zavrave u rrit me 36%, si pasojë e mungesës së furnizimit me qepë, patate dhe presh. Një kilogram nga këta artikuj kushtoi 120 lekë, gati dyfishin në raport me vitin 2018.



Fermerët në zonat prodhuese të vendit lajmërojnë një verë të acartë në çmime. Mariglen Ziu nga Kutallia e Beratit dje në mëngjes gjeti të gjitha bimët e kalbura nga ngricat (shih foton

bashkëngjitur). Një fidan domate ka kushtuar 25 lekë. Ferma duhet të rimbjellë, por ndërkohë kjo do të krijojë vonesa në sezonin e prodhimit e për rrjedhojë çmime të larta. Në këtë situatë janë të gjithë fermerët e serave.

Në Shqipëri, çmimet e ushqimeve përbëjnë më shumë se 70% të inflacionit, ndërsa brenda shportës dominojnë prodhimet vendase të fushës.

Fermerët shqiptarë të paorientuar me nevojat e tregut dhe çmimet, përveçse në shumë raste ekspozohen ndaj humbjeve të mëdha krijojnë edhe probleme në furnizimin normal të tregut me prodhime të vendit.

Ekspertët e bujqësisë këshillojnë se, qeveria duhet të jetë më orientuese ndaj prodhimit bujqësor me nevojat që ka tregu dhe

konsumatorët duhet të nxiten të konsumojnë prodhim vendas në vend të konsumojnë mollë maqedonase ose italiane, kur prodhimi vendas kalbet në fushë.
Revista "Monitor"

Skema e re e TVSH-së po dëmton prodhimin vendas të qumështit. U rritën ndjeshëm importet e bulmetit nga Serbia në 2021

Tkurrja e blegtorisë, rënia e numrit të krerëve dhe ndryshimet e vazhdueshme të skemës së kompensimit të TVSH-së kanë rritur nevojën për importet të bulmetit nga jashtë vendit.

Të dhënat e INSTAT mbi tregtinë e jashtme, gjatë vitit 2021, tregojnë se importet e bulmetit, vezëve dhe mjaltit u rritën me 27% vitin e kaluar, duke arritur vlerën totale prej 4,7 miliardë lekësh (38,8 milionë euro).

Të dhëna më të detajuara tregojnë se, importet në këtë grup udhëhiqen nga bulmeti

shumti nga një skemë fiskale e pafavorshme që u ndoq pas vitit 2019. Para këtij viti, në skemën e vjetër, vlera e kompensimit të TVSH-së ishte 20%, ndërsa nga 1 janari 2019 është 6%, për rrjedhojë pagesa e TVSH-së nga blegjësit është së paku trefish më e lartë.

Nga 1 janari 2022, TVSH e kompensuar është zero, ndërsa fermerët do të kompensohen, sipas një skeme që ende nuk është bërë e ditur nga Ministria e Bujqësisë. Heqja e kompensimit të TVSH-së u kundërshtua fort nga prodhuesit e qumështit, me argumentin se

ipëri ka mbi investime në linjat e përpunimit të qumështit në një kohë që lënda e parë sa po e vjen e po tkurret nga rënia e numrit të bagëtive.

Për të mbajtur normat e prodhimit, disa fabrika marrin lëndë të parë jashtë vendit, por vitet e fundit furnizimet me bulmet nga Serbia dhe Ukraina janë rritur ndjeshëm. Në krahasim me para-pandeminë, importet e bulmetit nga Serbia u rritën me 36%. Të dhënat e INSTAT tregojnë se deri në vitin 2018, importet e bulmetit nga Serbia ishin zero dhe blegjet nga kompanitë shqiptare të këtij produkti nga Serbia filluan vetëm në vitin 2019.

Bie numri i krerëve në blegtori dhe qumështit të grumbulluar

Sipas të dhënave të INSTAT, numri i krerëve në blegtori ka rënë dukshëm vitet e fundit. Numri i gjedhëve në vitin 2020 është 362.583 krerë, duke shënuar rënie me 12,76%, në krahasim me vitin 2019. Numri i të leshtave është 1,55 milionë krerë, duke shënuar rënie me 11,40%, krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu numri i dhive në vitin 2020 ishte 774.332 krerë, duke pësuar rënie vjetore me 10,26%, në krahasim me vitin 2019.

Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2020, sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar rezultoi rreth 119 mijë tonë, duke pësuar rënie me 14,80 %, krahasuar me vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe, sasia e qumështit të grumbulluar të lopës është rreth 101 mijë tonë, duke pësuar rënie me 18,45%, krahasuar me 2019.

Aktualisht Serbia e subvencionon tërësisht ciklin e prodhimit në bujqësi dhe agropërpunim.

dhe se rritja gjatë vitit 2021 është krijuar nga shtimi i importeve të qumështit nga Serbia, e cila ka ndikuar në 25% të totalit të rritjes totale.

Importet e bulmetit nga ky vend arritën në 327 milionë lekë në vitin 2021, me një rritje 251% në raport me vitin 2020.

Importuesit kryesorë janë fabrikat e qumështit, disa prej të cilave furnizohen me lëndë të parë nga Serbia, për shkak se kostot shpesh janë më të ulëta se ato nga tregu vendas. Serbia ishte partneri i tretë tregtar pas Italisë dhe Gjermanisë në importet e bulmetit dhe vezëve.

Rritja e importeve të qumështit u favorizua më së

do të rriste më tej kostot e prodhimit dhe do të reflektohet në shtrenjtimin e çmimeve.

Ndryshimet e shpeshta në skemën e TVSH-së rritën varësinë nga importet. Administratorët e fabrikave të përpunimit të qumështit kishin pohuar se, importi i qumështit bruto nga Ballkani është më me leverdi se blerja nga fermerët në tregun vendas. Fabrikat gjithnjë e më shumë po preferojnë të importojnë lëndën e parë, por kjo tendencë do të thotë faliment për blegtorët shqiptarë dhe rënie drastike e fitimeve të tyre.

Pesha e Serbisë në produktet e bulmetit është rritur ndjeshëm në pesë vitet e fundit. Në Shq-

Çmimi i qumështit fut në krizë blegtorët e Lushnjës! Ankohen fermerët: E shesim me 40 lekë/ litër, grumbulluesit abuzojnë

Numri i krerëve të lopëve po shkon drejt përgjysmimit. Në fshatin Lifaj të Lushnjës fermerët dhe blegtorët thonë se kanë humbur interesin për mbarëshkrimin e gjethëve për shkak se ka rënë ndjeshëm çmimi i shitjes së qumështit me shumicë. Në 5 vitet e fundit numri i krerëve të bagëtive është përgjysmuar

Numri i krerëve të lopëve po shkon drejt përgjysmimit. Në fshatin Lifaj të Lushnjës fermerët dhe blegtorët thonë se kanë humbur interesin për mbarëshkrimin e gjethëve për shkak se ka rënë ndjeshëm çmimi i shitjes së qumështit me shumicë. Sipas tyre nga 1200 që kishte ky fshat para 5 vitesh tani kanë mbetur rreth 500 krerë lopë.

"Unë kam pasur 5 krerë, kam vetëm një tani që e mbaj sa për qumësht për familjen. Problemi jone është sepse ka rënë vlera e qumështit, manipulohet nga fabrikat dhe e

marrin me çmim të lirë. Me 40 lek për litër e shesim aktualisht"- tha Vesel Kote, fermer.

"Kam pasur 12 krerë lopë dhe tani kam 3, por do ti heq, do ti there dhe këto se s'ka asnjë interes. Sot është 40 lek litri e qumështit. Blegtoria po shkatërrohet, skam marrë asnjëherë subvencionim"- u shpreh fermeri Shkëlqim Sulko.

Ku e shisni qumështin dhe sa lek me shumicë?

"Vjen e merr njëri këtu (grumbullues) e çon në bax-

ho. E shesim nga 38 deri në 40 lek një litër qumësht. I shita lopët unë u bënë 2 muaj, i hoqa lopët, ra pazari, ra qumështi. Kilja e ujit është 50 lek, kilja e qumështit 40 lek. Ca bëhet kështu?"- tha fermeri Eduardo Sulko.

Një tjetër shqetësim që ngrënë blegtorët dhe fermerët e Lushnjës është rritja e çmimit për inputet bujqësore.

"Inputet bujqësore kanë vajtur shumë shtrenjte, një kuintal ure 110 mijë lek! Për

Mjekja që u bë fermere - Historia e doktoreshës që sot rrit edhe 30 lopë

Midjana Hoçja, paradite vesh përparësen e bardhë të mjekes për të shpëtuar jetë njerëzish, ndërsa pasdite vjen në fermën e saj për t'u kujdesur për lopët

Doktoreshë Midjana thotë se ushqimi cilësor të siguron trup të shëndetshëm.

Midjana Hoçja: Kam investuar gjithë jetën time për t'u bërë një mjekë e mirë. Unë besoj se sot është koha që të gjithë të kthehemi tek toka dhe blegtoaria sepse ato janë baza e gjithçkaje dhe e shëndetit.

Para një viti në fermën e doktoreshës kishte 11 kokë lopë, ndërsa sot numërohen 30, kurse të ardhmen Midjana thotë se ajo do të ketë fermën

më të madhe në Shqipëri.

Midjana Hoçja: Synimi im është që këtë stallë ta nis dhe ta bëj sa më të madhe duke ngritur një fermë bashkëkohore me 300 kokë lopë.

Pasioni për blegtorinë asaj mësoi dhe bujqësinë, për këtë arsye në fshatin Gramëz të Fushë Krujës ajo mbolli shegë dhe ullinj.

Midjana Hoçja: Unë kam mbjellë shegë, ullinj, rrush dhe sera. Kjo do të jetë një fermë që do të ketë çdo gjë.

Histori si kjo e Midjanës të frymëzojnë që të punosh tokën e të mbarështosh gjënë e gjallë. Dëshira e Mirdianes është të ketë një fermë të madhe moderne, përtej pasionit për blegtorinë, ajo ka nevojë të subvencionohet nga M.B.

Momentalisht Industria e Përpunimit të Qumështit, furnizohet me qumështin që vjen nga Serbia, pasi fermerët i kanë braktisur stallat e tyre. Që të hamë produkte ushqimore cilësore, duhet që të mbështesim ata të rinj që kanë ëndrra të mëdha.



Kërpudhat, grumbullojmë mes 20-40 tonë, studimi: Investimi në përpunim do rriste dukshëm vlerën e shtuar

Kultivimi i kërpudhave në Shqipëri mbetet një aktivitet ende i kufizuar ndërkohë që një pjesë e mirë e këtij produkti mbledhet në natyrë.

Një studim sektorial i Ministrisë së Bujqësisë i cili ndalet tek diversifikimi merr në analizë ecurinë aktuale si dhe potencialin që mund të ketë sektori nëse investohet. Kështu sipas studimit sasia e grumbulluar e kërpudhave në vend është luhatur, nga 20 deri në 40 tonë.

“Një pjesë e madhe e kërpudhave mbledhen gjithashtu në Pukë, zonat kodrinore të Lezhës, Prespës dhe zonat malore të Korçës dhe Librazhdit. Puka njihet sasinë e madhe të kërpudhave të rritura në natyrë si dhe shumëllojshmërinë e tyre. Shumë kërpudha të egra rriten gjatë gjithë territorit të Pukës. Ka më shumë se 10 lloje kërpudhash të ngrënshme dhe 15 lloje helmuese. Më së shumti kërpudhat e egra të mbledhura/tregtueshme shpesh janë si më poshtë: Boletus (Boletus edulis), Chanterelle (Cantharellus cibarius), agarikë mbretërorë (Craterellus cornucopoides), Morel (Morchella conica) dhe kërpudha Caesars (Amanita Cezarea).

Për shumicën e familjeve rurale në Shqipëri, kërpudha është gjithashtu një produkt shumë i rëndësishëm duke pasur parasysh mundësitë e drejtpërdrejta për shitje në dyqan të specializuar dhe HoReCa. Mbledhësit

dhe konsoliduesit prokurojnë produktin e mbledhur bazuar në pagesa sipas rastit dhe përdorin automjete të vogla (maksimumi 2 ton) për shitjen e produkteve” thuhet në studim.

Kalimi nga hallka e mbledhësit tek grumbulluesi rrit fitimet për këtë të fundit në mënyrë të dukshme dhe studimi ka dalë në për-



fundimin se marzhi i fitimit është 25-35% mbi atë të mbledhësit.

“Shumë mbledhës ofrojnë boronica të egra, kërpudha dhe arra në pikat e vogla të grumbullimit ose direkt tek operatorët kryesore në zona të tilla. Shqetësues është cilësia e ulët e produktit në periudhën pas vjeljes sepse çmimi ulet dhe një pjesë e produktit është hiqet pas përzgjedhjes. Për shkak të mungesës së lidhjeve të tregut, njohurive të dobëta dhe kapitalit për të investuar pas vjeljes dhe përpunimit krijon vlerë të dobët të shtuar brenda fermës. Pjesa më e madhe e produktit shitet i papërpunuar (në Pukë

93 % e produkteve)” thuhet në studim.

I njëjti analizon se përmirësimi teknologjik duke përpunuar produktin fillestar do të rriste dukshëm fitimin.

“Në 2019 eksporti i kërpudhave ishte me një çmim 7.3 euro për kg. Volumi i eksportit ishte 21 ton. Baza për ar-

ritjen e konkurrencës në tregjet ndërkombëtare është përmirësimi teknik dhe i aspekteve teknologjike si dhe standardizimi dhe certifikimi. Tregjet e brendshme bazohen në shitjen direkte. Për shkak të mungesës së njohurive pas vjeljes produkti shitet i freskët ose i thatë në paketime të vogla. Produkti i freskët shitet menjëherë informalisht në restorantet e qytetit.

Përpunim do të rriste vlerën e shtuar pasi 7-10 kilogram kërpudha do të prodhohin 1 kg të thata dhe shitja me rreth 45 euro ndërkohë që në tregjet e huaj ky çmim është rreth 65 euro” thuhet në dokument.

Open Balkan për bujqësinë - Ekspertët: Përfitojmë vetëm nëse rritet buxheti nga qeveria

Open Balkan do ta ndihmojë bujqësinë shqiptare nëse qeveria shqiptare do të rrisë buxhetin për fermerët



Prodhimet bujqësore shqiptare do të bëhen konkurruese në tregun rajonal vetëm nëse ulen kostot e prodhimit.

Open Balkan do të sjellë zhvillim në sektorin e Perimeve, Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, të Pemëtarisë, të Vreshtarisë dhe Turizmit Rural, por nga ana tjetër do të vihen në vështirësi Industria Agropërpunuese, Prodhimi i foragjereve dhe Sektori i Blegtorisë në tërësi.

“Open Balkan do të sjellë avantazhe për fermerët, sepse tek perimet e freskëta, mandarinat, vaji i ullirit, bimët mjeksore aromatike dhe agroturizmi kemi përvojë pozitive dhe potenciale më konkurruese

në treg. Disavantazhet që ka Open Balkan janë përparësitë që ata kanë në zënieën e tregut. Ne kemi disavantazh se shumë produkte të sektorit të agropërpunimit nuk arrijmë t'i prodhojmë me kostot, standardin dhe cilësinë e kërkuar edhe për supermarketet tona. Dhe ky është një avatazh për konkurentët tanë, pasi Ata me shumë lehtësi do të sjellin mallrat e Tyre që plotësojnë kriteret e kërkuara nga supermarketet tona. Kjo vjen si pasojë e disavantazhit që kemi në kosto, në teknologji, në certifikim dhe në linja paketimi dhe përpunimi”, tha Agim Rrapaj, nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar.

Drejt “zhdukjes” kultivimi i kërmillit, numri i fermave ulet ndjeshëm

Disa vite më parë numri i atyre që vendosën të investonin në një fermë kërmilli pësoi rritje të ndjeshme nën “joshjen” e një biznesi me fitim.

Por gjatë rrugës jo të paktë ishin ata që u zhgënjyën duke e braktisur si aktivitet dhe sot sasia e kultivuar mbetet modeste. Të dhënat zyrtare nga Ministria e Bujqësisë tregojnë se numri i fermave është tashmë më pak se pesë dhe po shkon drejt uljes ndërsa eksportet janë rreth 400 tonë.

“Kultivimi i kërmillit është i orientuar kryesisht nga eksporti. Vendi po prodhon 400 ton kërmij. Ka pak fermerë që kultivojnë kërmij dhe shitja e tij bëhet me një me çmim 4 euro për kg. Rendimenti është 12 ton për ha. Operatorët janë nga Durrësi dhe Fieri. Edhe pse prodhimi i kërmillit ka disa nënprodukte, pjesa më e madhe janë kërmijtë e freskët. Aktualisht kultivimi është thuajse inekzistent” thuhet në dokumentin e Ministrisë.

Sipas të njëjtit studim tregu i kërmijve është i orientuar kryesisht drejt eksportit të vjeljes së të egrit ndërsa kultivimi aktualisht ndiqet nga dy operatorë. Tregu ka një vlerë të përafërt prej 400 mijë euro

që eksportohet. Në terma të volumit, vlera e eksportit është në stanjacion. Pjesa kryesore e eksportit është drejt industrisë kozmetike ndërsa një pjesë tjetër e prodhimit shitet edhe në tregun e brendshëm. Kryesisht



restorantet blerjet e tyre i kanë direkte për kërmij që nuk janë të kultivuar por të mbledhur në natyrë. Nuk ekziston sot një treg i brendshëm për kërmijtë për qëllime jo ushqimore.

“Kultivimi i kërmillit ka nevoja për frigoriferë, rrjeta dhe struktura për fermat, makineri të vogla për përgatitjen e tokës. Megjithatë, gjatë viteve të fundit një pjesë e madhe e operatorëve të sektorit kanë mbyllur aktivitetin e tyre dhe numri i

Gjithashtu probleme ka edhe aktualisht, por do të agrarohen më shumë në të ardhmen veçanërisht për Industrinë e Përpunimit të qumështit, sepse një litër qumësht nga Serbia pa TVSH blihet me 48 lekë. Ndërsa litri i qumështit në fermat shqiptare pa TVSH shitet me 52 Lekë. Aktualisht po importohet qumësht si lëndë e parë, por trendi mund të ndryshojë në të ardhmen, duke na imponuar të importojmë nënprodukte të gatshme.

Qumështi nga Serbia aktualisht vjen i standartizuar dhe pasterizuar, për agropërpunuesit tanë kjo do të thotë me pak procese teknologjike, më pak shfrytëzim i kapaciteteve tona përpunuese, më pak punë, më shumë vështirësi në kthimin e kredive si dhe rritje e kostove të prodhimit të disa nënprodukteve me origjinë shtazore.

Nëse blegtoaria vendase, prodhimi i ushqimeve për blegtorinë si dhe industria agropërpunuese nuk do të mbështetet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe qeveria, veçanërisht importi i qumështit nga rajoni, shumë shpejt rrezikon të mbizotërojë në tregun shqiptar.

fermave është zvogëluar nga më shumë se 10 deri në më pak se 5” thuhet në dokument.

Ecuria e dobët pa ndonjë interes për tregun e kërmijve ka bërë që nga ana e ekspertëve të sugjerohet që nëse

do të ketë masa mbështetëse kultivimi i kërmijve të mos jetë pjesë e tij.

Dokumenti sqaron se në rastin e kërmijve kërkohen pak investime përveç mbështetjes me ngritjen e kapaciteteve dhe informacionin për tregun. Po kështu kërkohet rritje e qëndrueshme në kapacitetin menaxhues dhe njohuritë teknike, si dhe mbështetje për rritjen e aksesit në tregje kërkohet.

Revista "Monitor"

Universiteti Bujqësor i Tiranës zgjeron bashkëpunimin ndërkombëtar

(Vijon nga faqja 4)

Zingraf: Ky program doktoraturash, hap shtegun për zhvillim

Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, Peter Zingraf tha se, “është kënaqësi të rikthehem këtu në këtë universitet të madh, menjëherë pas festimit të 70-vjetorit të krijimit të tij. Është kënaqësi të bëhemi bashkë për të prezantuar këtë program të doktoraturave në fushën e bujqësisë pas kaq shumë përpjekjesh të bëra nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë iniciativë”.

Ai tha se, shumë përpjekje dhe energji janë ofruar në përgatitjen e këtij programi që është dëshmi për të ardhmen e këtij sektori dhe të brezit të ri. “Programi i doktoraturave në UBT, është e rëndësishme

për të ngritur kapacitetet njerëzore në sektorin bujqësor dhe do të ndihmojë në krijimin e një grupi ekspertësh me njohuri të thelluara të mbështetura në politika shkencore që i shërbejnë edhe negociatave të anëtarësimit në BE”, theksoi Zingraf.

Ambasadori solli në vëmendje se, për më tepër në kontekstin e të shkuarës shqiptare dhe të aderimit të Shqipërisë në BE, është e nevojshme të fuqizohet bashkëpunimi shkencor mes universiteteve evropiane.

“Duke patur 70 vjet përvojë UBT është një shtyllë e rëndësishme e sistemit universitar shqiptar dhe ka krijuar lidhje shumë të mira me universitetet evropiane dhe veçanërisht me ato gjermane”, theksoi Zingraf.

Zingraf vuri në dukje se, ky program doktoraturash do të shërbejë si një shembull i mirë dhe do të hapë shtegun për

zhvillim. Gjatë fjalës së tij, Zingraf, vlerësoi se bujqësia është e rëndësishme për Shqipërinë dhe jep 20 % PBB dhe ka mbi 40 % të të angazhuarve në punë. Ndaj dhe ne nisëm këtë program që në 2019 nëpërmjet GIZ, që synon të mbështesë bujqësinë dhe zhvillimin rural në bashkëpunim të ngushtë me MBZHR.

“Qëllimi është i qarë që bujqësia duhet të digjitalizohet dhe modernizohet për të qenë konkurruese në treg. Ne besojmë që brezi i ri duke patur arsimimin e duhur do të sjelli një perspektivë tjetër duke kontribuar në zhvillimin e bujqësisë. Si një donator dypalësh jam i kënaqur që po mbështesim këto mundësi. GIZ ka zbatuar projekte që kanë rritur punësimin, zhvilluar sipërmarrjet dhe arsimimin e të rinjve në këtë sektor”, deklaroi Zingraf.

Çmimi i qumështit fut në krizë blegtorët e Lushnjës! Ankohen fermerët: E shesim me 40 lekë/litrë, grumbulluesit abuzojnë

(Vijon nga faqja 5)

shkak të pamundësisë kemi lënë grurin pa i hedhur plehun. Këtu është katastrofë, ka marre fund çdo gjë. Qeveria të hedh sytë nga fshati. Koncentrati i misrit ka shkuar 450 lek/kg. 120 mijë lek kushton kuintali i uresë, 130 kuintali i DAP, blegtorja ka vajtur në greminë”.- tha fermeri, Shkëlqim Sulko.

Kërkesa e tyre për Ministrinë e Bujqësisë dhe atë të Financave është ndryshimi i skemës së subvencioneve. Subvencioni për njësi prodhimi e nxjerr blegtorinë nga kriza.



“Kjo situatë zgjidhet vetëm me subvencionim 100 lek për litër/qumësht dhe 100 mijë lek për krerë”.- tha Shkëlqim Sulko.

Çmimet e larta të plehura kimikë, heqja e skemës së subvencionit dhe mungesa e punonjësve e kanë rënduar klimën e bizneseve në bujqësi.

Perimet dhe frutat që nuk e durojnë dot njëra tjetrën

Fqinjësia e mirë është e rëndësishme jo vetëm për njeriun por edhe për bimët dhe specie të tjera.

Në kopshtari e dimë që ka bimë që rriten mirë në shoqëri dhe njëra tjetrës.

I tillë është rasti i fenomenit të ashtuquajtur ‘Tre Motrat’ ose kungullit të verdhë, misrit dhe fasuleve që rriten së bashku në mënyrë perfekte.

Misri shërben si një trinë për fasulet dhe fasulet janë bujare në ushqyerjen e tokës ndërkohë që githnjëja e kungullit mban larg barin e keq dhe ruan lagështinë e tokës.

Megjithatë ky është një shembull i vetëm sepse shumë bimë janë armike të përbetuar të njëra tjetrës.

Më poshtë do të gjeni shtatë kombinimet bimore që thjesht nuk funksionojnë.

Qepët e njoma dhe bizelet

Ekspertët e AgroWeb.org

shpjegojnë se anëtarët e të njëjtës familje botanike të qepës – përfshirë këtu, hudhrën dhe qepujkat- me bizelet.

Qepët kanë aftësinë të pengojnë rritjen e bizeleve.

Patatet dhe domatet

Ekspertët thonë se duhet të prisni telashe nëse mbillni domatet bashkë me patatet.

Kur mbillen së bashku sëmundjet botanike përhapen më shpejt.

Specat dhe fasulet

Ekspertët e AgroWeb.org thonë se specat dhe fasulet infektohen më shpejt nëse mbillen krahu njëra tjetrës.

Karrotat dhe kopra

Janë armike të përbetuar sipas ekspertëve por studimet shkencore mbi arsyet përse kjo armiqësi është kaq e ashpër vazhdojnë akoma.

Lakra dhe rrushi

Legjendë urbane ose një e vërtetë, rrushi me lakrën e urrejnë njëra tjetrën.

Besohet se nëse lakra mbillet pranë vreshtave me rrush, vera e bërë në shtëpi do të ketë shije të keqe. Kjo bestytni ekziston që 2000 vite më parë.

Domatet dhe arrat

Arrorët njihen si fqinj të këqinj. Pemët emetojnë një lëndë kimike dhe toksike që shkatërron bimët e mbjella përreth siç mund të jenë domatet.

Sallata jeshile dhe brokoli


Studimet kanë treguar se sallata jeshile është shumë e ndjeshme ndaj lëndëve kimike që lëshojnë brokollit.

Kopshtaria është art më vete, por nëse nuk i zbaton teknikën dhe udhërrëfyesit e saktë, mund të kthehet në makth.

/AgroWeb.org

Projekti ambicioz - Renditja e plotë e gjenomit të të gjitha specieve të gjalla në Tokë!

A ju kujtohet Projekti i Gjenomit Njerëzor, projekti ambicioz i nisur në vitin 1990 dhe i cili brenda 13 viteve ishte në gjendje të rendiste të



gjithë gjenomin njerëzor? Që atëherë, teknikat e renditjes janë përmirësuar në mënyrë eksponenciale dhe ajo që dikur kërkonte vite mund të arrihet në shumë më pak kohë. Dhe nuk ka demonstrim më të mirë se Projekti Toka BioGenome, një projekt kaq ambicioz sa krijuesit e tij e kanë përcaktuar atë, në një speciale të publikuar në PNAS, “një goditje hënë”, të cilën mund ta përkthejmë si “një kimerë”. Qëllimi i saj? Për të renditur, brenda dhjetë viteve të ardhshme, gjenomin e plotë të të gjitha specieve të gjalla në Tokë.

Objektivi i vërtetë i projektit është të hartojë gjenomën e të gjitha specieve të njohura – një dokument i vitit 2011

vlerëson se ka rreth 8.7 milionë lloje në Tokë, por në fakt ne i kemi identifikuar dhe përshkruar ‘vetëm’ rreth 1.8 milionë. Pikërisht në to, për momen-

te, fokusohet Projekti Earth BioGenome, i cili përfshin 44 universitete dhe institute kërkimore të shpërndara në 22 vende të botës, si dhe pesëdhjetë projekte të tjera të lidhura që do të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave. Qëllimi i renditjes së gjenomit të gati dy milionë specieve të gjalla duket i paarrtshëm, por siç shpjegon Jenny Graves, profesore e gjenetikës në Universitetin La Trobe dhe anëtare e EBP në The Conversation, është bërë i mundur nga përparimi i madh i bërë vitet e fundit nga teknikat e sekuencave. Graves shpjegon se ajo që dikur kërkonte vite, tani mund të arrihet në një kohë relativisht të shkurtër dhe mbi të gjitha me një çmim

tin, fokusohet Projekti Earth BioGenome, i cili përfshin 44 universitete dhe institute kërkimore të shpërndara në 22 vende të botës, si dhe pesëdhjetë projekte të tjera të lidhura që do të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave. Qëllimi i renditjes së gjenomit të gati dy milionë specieve të gjalla duket i paarrtshëm, por siç shpjegon Jenny Graves, profesore e gjenetikës në Universitetin La Trobe dhe anëtare e EBP në The Conversation, është bërë i mundur nga përparimi i madh i bërë vitet e fundit nga teknikat e sekuencave. Graves shpjegon se ajo që dikur kërkonte vite, tani mund të arrihet në një kohë relativisht të shkurtër dhe mbi të gjitha me një çmim

të ulët: disa mijëra dollarë për një gjenom të plotë, krahasuar me miliona disa vite më parë. Sipas Graves, kostoja totale e të gjithë EBP do të jetë më e vogël se shuma e shpenzuar për Projektin e Gjenomit Njerëzor, i cili u fokusua në një specie të vetme dhe jo gati dy milionë specie të ndryshme.

Afati kohor i Projektit të Tokës BioGenome përfshin tre faza. Në të parën do të sekuencohet gjenomi i rreth 9400 specieve të gjalla, secili përfaqësues i një familjeje të ndryshme taksonomike: kjo fazë duhet të përfundojë deri në vitin 2022. Më pas do të kalojmë në hapin tjetër: ka rreth 180.000 gjini të ndryshme në natyrë. dhe EBP do të renditë kështu gjenomin e 180,000 specieve model. Faza e tretë dhe e fundit do të shkojë në edhe më shumë detaje: është ajo në të cilën gjenomi i çdo specie të vetme të njohur do të renditet. Prandaj, brenda dhjetë viteve, EBP pret që të ketë në dispozicion gjenomet e plota të çdo kafshe, bime, kërpudhe dhe të gjithë eukariotëve të tjerë të njohur: një manual i vërtetë i historisë së jetës dhe evolucionit, i cili gjithashtu do të jetë i dobishëm për të kuptuar se si të mbrohen më së miri sekuencat e specieve. FCS

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike trajnim mbi sigurinë ushqimore

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) organizoi trajnimin mbi “Sigurinë ushqimore, veterinarinë, mbrojtja e bimëve dhe sfidat e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian” me ekspertet Yllka Allaraj, Admir Ago, Ismet Bici.

Ky trajnim u organizua në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori shqiptar” në kuadër të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve në

Shqipëri për të arritur standardet evropiane” - PROJEKT ME – i financuar nga Bashkimi Evropian që po zbatohet nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” në bashkëpunim me organizatën e Malit të Zi, “Center for Monitoring and Research (CeMI)” së bashku me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejto-

ria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtoritë Rajonale të AKU-së, Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia e Tiranës.

Fokus i trajnimit ishte rritja e sigurisë ushqimore si kusht i domosdoshëm në integrimin evropian të vendit dhe faktor i rëndësishëm në rritjen e eksporteve dhe sigurinë e shëndetit të njerëzve.



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR



SHOQATAT ANETARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në

7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

KËNDI I EKSPERTIT**MJELJA****Higjena e qumështit - kërkesat bazë për cilësinë dhe sigurinë e qumështit****Kushtet sanitare të tufës**

Kafshët që japin qumështin e papërpunuar duhet të jenë të shëndetshme dhe të plotësojnë kushtet si më poshtë:

1. Të mos tregojnë simptoma të sëmundjeve infektive të transmetueshme te njerëzit si bruceloza dhe tuberkulozi.

2. Te tregojnë një shëndet të mirë të përgjithshëm dhe të mos jene të prekura nga infeksionet e gjirit (mastitet).

3. Te jene respektuar periudhat e pezullimit, në rastin e bërjes së vaksinave ose ilaçeve të autorizuara, të parashikuara për këto produkte.

Në veçanti, për sa i përket tuberkulozit dhe brucelozës, qumështi i papërpunuar mund të përdoret vetëm nëse vjen nga tufa zyrtarisht të pa prekurra, të kontrolluara rregullisht ose të vaksinuara posaçërisht për këto sëmundje. Nëse tufat janë vaksinuar dhe këto vakcinime janë shënuar siç duhet në regjistrin e fermës, atëherë qumështi është i përshtatshëm për konsum dhe mund të përdoret për përpunim. Nëse, në të njëjtën fermë, ka edhe dhi edhe lopë, dhe janë regjistruar raste të tuberkulozit tek gjedhët, është e nevojshme që të testohen për këtë sëmundje edhe bagëtitë e imta para se të fillohet prodhimi dhe përpunimi i qumështit të tyre.

Nëse tufa është e prekur nga tuberkulozi ose bruceloza, kafshët e infektuara duhet të ndahen menjëherë nga pjesa tjetër e bagëtive. Së fundmi, për sa i përket brucelozës, nëse qumështi nuk vjen nga një tufë zyrtarisht e prekur dhe që është e vaksinuar, është e mundur që të përdoret për përpunimin e djathrave që kërkojnë një periudhë stazhionimi, prej së paku dy muajsh.

Higjiena e mjeljes në ferma

Mjelja përbën një nga operacionet më të rëndësishme tek bagëtitë e imta, e lidhur ngushtë me higjienën, mastitet, cilësinë e qumështit, si dhe angazhimin e fuqisë punëtore. Kushtet paraprak është mjedisi i paster, ndaj duhen siguruar dysheme të thata e të pastra, si dhe mjedise të drenazuara përreth stallës.

Higjiena e mjeljes përfshin proceset para dhe pas mjeljes, si dhe pastërtinë e pajisjeve të përdorura për mjeljen e lopëve.

Higjiena e paramjeljes dhe pasmjeljes garantoher në këtë mënyrë:

- *Dezinfektimi i thithave para mjeljes me solucion dezinfektant dhe gota dezinfektimi*

Thithat duhet të dezinfektohen me një solucion të miratuar për të zvogëluar ngarkesën e bakteve patogene mjedisore në gj. Mjelësit duhet të udhëzohen që të heqin dorë nga njomja e gjirit gjatë procesit të para-mjeljes, pasi uji me or-

ganizma që shkaktojnë mastitë do të rrjedhë nga lëkura e gjirit drejt thithit duke rritur kështu rritur kështu ngarkesën bakteriale të qumështit. Si solucione dezinfektuese te rekomanduara njihen tretësira jodi, klorheksidina ose klorine dioksidi. Solucioni duhet të mbetet në kontakt me thithkën për 30 sekonda për të lejuar dezinfektimin e duhur. Aplikimi i dezinfektimit me gotë rekomandohet me shume se mbi spërkatja e thithëve sepse kjo jo gjithmonë çon në mbulim uniform të zhytjes së thithit. Mbas trajtimit të duhur me dezinfektant të thithave, ngarkesa bakteriale në to duhet të zvogëlohet ndjeshëm. Solucionet mund të aplikohen si lëng ose si shkumë; të dyja metodat janë provuar se janë njësoj të dobishme.

- *Fshirja e thatë me pecetë të pastër*

Një peshqir letre ose leckë për përdorim individual duhet të përdoret për të pastruar dhe tharëbazën e thithit si dhe majen e tij. Procesi i pastrimit të gjirit duhet të përqëndrohet në majen e thithit. Të dhënat kanë treguar se përdorimi i dezinfektuesit dhe një peshqiri individual largon pjesën më të madhe të bakteve nga thithat në krahasim me pastrimin e thithave pa dezinfektues ose me një peshqir të vetëm. Mos përdorni një peshqir ose tretësirë të zakonshme për të pastruar thithkat e bagëtive, sepse kjo rrit rrezikun e transferimit të organizmave që shkaktojnë mastitë si *Staphylococcus aureus* dhe *S. agalactiae* nga dhia ne dhi.

- *Pastrimi i zones nga leshi (qimet) sa herë të jetë e nevojshme, duke pastruar gjirin me peceta të pastra*

Pastrimi nga qimet është një komponent jetik i rutinës së para – mjeljes, sepse lejon mjelësit të identifikojnë qumështin jonormal dhe gjithashtu vepron si një formë stimulimi, duke çuar në lirim e oksitocinës. Infeksionet e gjëndrave të qumështit mund të kenë inflamacion, ënjtje, skuqje ose një çerek gjiri të nxehtë, secila prej të cilave mund të identifkohet nga një mjelës i zgjuar dhe i vëmendshëm gjatë pastrimit të qimeve.

- *Higjena personale*

Para se të fillojë mjeljen, punëtori duhet të lajë duart me ujë dhe sapun. Të vishen këpucë të pastra kur hyni në zonën e mjeljes. Të shmangët pjesëmarrja në mjelje nëse keni sëmundje infektive ose lëndime në duar.

- *Mbajtja e dorezave gjatë mjeljes*

Mjelësit duhet të mbajnë doreza nitrile ose latex, për të zvogëluar rrezikun e transferimit të organizmave që

shkaktojnë mastitë nga një dhi/ dele në tjetrën përmes duarve të mjelësve. Dorezat duhet të dezinfektohen me një tretësirë të përbërë nga 50 ppm jod ose tretësirë tjetër dezinfektuese. Dorezat e grisura duhet të hiqen dhe zëvendësohen.

- *Enët e qumështit*

Enët e qumështit preferohen bidona inoxi, por për shkak të peshës dhe kostos së lartë, gjejmë gjerësisht në përdorim edhe bidona plastikë apo alumini. Në këtë rast, duhet patur kujdes që të mos kenë çarje ose ndryshk, pasi papastërtia mund ta ndotë qumështin; ato duhet të kenë një qafë të gjerë për të lehtësuar pastrimin, dhe duhet të përdoren vetëm për qumësht.

- *Dezinfektimi pas mjeljes*

Dezinfektimi pas mjeljes përdoret për të parandaluar infeksionet e reja të shkaktuara nga organizmat ngjitës. Solucionet dezinfektuese zakonisht përmbajnë një përqendrim më të lartë dezinfektuesi, si dhe zbutës me qëllim që të ruajnë thithat nga tharja dhe plasaritja. Përqendrimi më i lartë i dezinfektuesit është gjithashtu i rëndësishëm në kontrollin e infeksioneve të reja mjedisore, duke vënë në dukje se fundi i thithit mund të mbetet i hapur për 1 orë ose më shumë pas mjeljes. Trajtimi aplikohet në të gjithë gjirin, duke shpërndarë me kujdes një pikë që vendoset në fund të gjirit. Solucionet dezinfektuese të pas-mjeljes përfshijnë tretësirë jodi, clorhexidine, peroksid hidrogjeni, hipoklorit natriumi dhe hidroksid amoni. Megjithatë, tretësira e jodit 1% është ajo që përdoret më gjerësisht, pasi është në gjendje të ruajë gjatë në kohë aftësinë dezinfektuese.

- *Çfarë duhet patur kujdes me solucionet dezinfektuese*

Magazini, përzjerja e duhur dhe datat e “përdorimit” janë të gjithë përbërës të rëndësishëm që duhet të keni parasysh kur punoni me dezinfektues të thithit. Në ditët e sotme, në fermat e mbarështrimit të bagëtive, po përdoret gjithnjë e më shumë përzjerja e solucioneve dezinfektuese. Në këtë drejtim merr rëndësi të vecantë pastërtia e ujit të përdorur. Duhet patur kujdes që uji të mos jetë i kontaminuar kur ky proces kryhet. Në shumicën e rasteve uji i përdorur vjen nga ujësjellësi, ky rast nuk përbën problem kontaminimi. Vëmendje e vecantë duhet kushtuar kur uji për përgatitjen e përzjerjeve të solucioneve dezinfektuese merret nga pusi, pasi shanset për kontaminim shpesh janë të larta.

Dezinfektuesit e thithave duhet të ruhen në zona që parandalojnë ngrirjen e tyre, sepse procesi i ngrirjes do të bëjë që komponentët e solucionit të ndahen. Përbërja e

solucionit dhe komponenti aktiv i tij, mund të shkaktojnë irrim të lartë të gjirit të bagëtisë, nëqoftëse solucioni ka ngrire paraprakisht e më pas është shkrirë për tu përdorur. Fermerët duhet të vërojnë me kujdes datën e skadencës së solucioneve dezinfektuese, pasi kur kjo datë tejkalohet, efikasiteti i dezinfektimit ulët ndjeshëm.

- *Dezinfektimi dhe pastërtia e pajisjeve të përdorura pas mjeljes lopëve.*

Shplarja e njësisë së mjeljes me solucion dezinfektues është një formë tjetër e dezinfektimit që mund të zvogëlojë përhapjen e organizmave që shkaktojnë mastitë nga lopa në lopë përmes njësisë së mjeljes. Mbushja e njësisë së mjeljes me 30 deri në 50 ppm tretësira jodi do të zvogëlojë, por nuk do të eliminojë organizmat që shkaktojnë mastitë. Kostoja e pajisjeve mekanike të shpëlarjes mund të jetë e lartë; megjithatë, pastrimi manual i dorës është gjithmonë një opsjon.

Shplarja manuale është procesi i marrjes së një zorre uji që trajtohet me jod dhe futja e grykës së zorrës në linje. Ky proces dëbon mbetjet e qumështit, ndërsa dezinfekton shtrësat. Ky përbërës dhe tubave, duke përfshirë cdo kthesë të linjes. Ky proces duhet detyrimisht të përdoret pas mjeljes së bagëtive me një SCC të lartë.

Makinat automatike të mjeljes: kapaciteti, koha e mjeljes, rregullat e higjenes, avantazhet e përdorimit

Si fillim ju ftoj të ndiqni materialin filmik, që tregon funksionimin e një sistemi automatik të mjeljes së dhive.

Përdorimi i makinerisë mjelëse paraqet një zgjidhje të mirë për fermat që kanë të paktën njëqind krerë. Avantazhet e mjeljes mekanike janë të dukshme jo vetëm në aspektin e kohës, por edhe në karakteristikat higjienike të qumështit, i cili do të ketë një ngarkesë bakteriale shumë më të ulët sesa mjelja me dorë. Sidoqoftë, nëse mjelja nuk kryhet siç duhet ose me një impiant që funksionon keq apo është i papastër, mund të lehtësojë krijimin e mastitit dhe transmetimin e tij nga njëra kafshë tek kafshët e tjera. Gjëja e parë që duhet kontrolluar është madhësia e grykës së kellefit të pompës thithëse (shiko ilustrimin në fig.1, ekstremiteti transparent) i cili nuk duhet të jetë as shumë i ngushtë e as shumë i gjerë. Këllëfi duhet të futet mirë në thithkë, duke e lënë të lirë vetëm fundin, në mënyrë që boshllëku të mund të veprojë në majën e gjirit. Gryka e kellefit shumë e ngushtë shkakton dhimbje të thithave dhe mund të çojë në sëmundje të gjirit. Para se të vendoset mjelësja në secilën

kafshë, gjinjte duhet të dezinfektohen dhe pastrohen, siç u spjegua me lart.




Fig.1. Pompë thithëse

Në mungesë të sistemeve për heqjen automatike të grupit të thithësëve, të hiqen menjëherë thithëset pasi të jetë mbyllur valvula e duhur e vakuumit.

Para këtij veprimi, të masazhohen gjinjte i grupet akoma të vendosura në të, në mënyrë që të përfitohet sërish një sasi qumështi pasi të ketë përfunduar nxjerrja spontane e tij dhe të shmangen traumat.

Sapo të përfundohet mjelja, pas rreth 5 minutash, të mbushet një kovë me ujë të pastër dhe të ftohtë me rreth 10-15 litra, makina mjelëse të lihet në punë derisa të mbarojë të gjithë uji. Pas këtij veprimi të zbrazen bidonët e makinës mjelëse. Më pas të përsëritet ky veprim me ujë të nxehtë, edhe dy herë nëse është e nevojshme, duke zbrazur bidonët e makinës mjelëse dhe duke përdorur të njëjtin ujë.

Nëse pas këtyre veprimeve uji brenda bidonit do të jetë sërish i pisët, të bëhet edhe një larje tjetër me ujë të ftohtë. Gjithashtu, të paktën një herë në javë duhen pastruar tubat e pajisjes dhe kolektori i makinerisë mjelëse, duke çmontuar e pastruar thithëset dhe duke hequr kapakun pjesa blu në fig.1). Gjatë këtij veprimi u duhet kushtuar shumë vëmendje pastrimit të çdo diametri dhe harqeve të tubave, që janë dhe pikat ku grumbullohen më së shumti papastërtitë.

Pasi të çmontohen elementet, të pastrohen në të dy anët me pastruesin e tubave. Të pastrohet me kujdes kolektori (elementi numër 3 në pamjen vijuese) ku tentojnë të formohen mbetje, të cilat përveç se favorizojnë shtimin e bakteve, mund të shkaktojnë vështirësi në kalimin e qumështit.




Fig.2. Grupi i thithësëve i formuar nga: thithëset plastike (1), tubat (2) dhe kolektori i qumështit (3), (pajisje lidhëse që bashkon tubat e shkurtër dhe të gjatë të qumështit)

Ky veprim duhet kryer me ujë të ngrorhtë dhe soucion dezinfektues specifik rreth 4-5 herë. Ndërsa në fund, duhet të përsëritet procedura edhe një

herë me ujë të ftohtë.

Sidoqoftë, është gjithmonë mirë të lahet makina e mjeljes mekanike duke respektuar kohët, shpeshtësinë me pastruesit specifikë sipas udhëzimeve të firmës prodhuese. Do të ishte pozitive të monitorohej cilësia e ujit që përdoret për larjen e makinës mjelëse.

Kushtet e grumbullimit dhe transportit të qumështit nga ferma në fabrikë; monitorimi i temperaturës së ruajtjes në pikat e grumbullimit dhe në mjetet e transportit në mënyrë dixhitale**2.3.1 Ftohja në fermat prodhuese dhe pikat e grumbullimit**

Menyra më e mirë për të siguruar cilësi të lartë të qumështit si lëndë e parë për përpunim është ftohja e tij e menjëhershme pas mjeljes. Kjo gjë do të pengojë zhvillimin e mikrororganizmave të dëmshëm dhe rritjen e ngarkesës bakteriale. Për këtë qëllim, qumështi ruhet në tanke të ftohjes, të cilat janë enë inoxi me këmishë. Në këmishë, si agjent ftohës futet uji i akullt i prodhur nga grupi frigoriferik i tankut (Fig.3). Përzjerja mekanike e vazhdueshme e qumështit ndihmon ftohjen uniforme të tij brenda tankut. Këto tanke ftohës vendosen në dy raste:

- Në ferma të mëdha të prodhimit të qumështit

- Në pikat e grumbullimit

Tanku ftohës i Fig.3 është tipik për tanket që vendosen pranë fermave të mëdha prodhuese.



Fig.3 Tank ftohës vendosur pranë stallës

Fermat me pak krerë, e mbledhin qumështin në bidona inox dhe duhet ta dërgojnë brenda 2-3 orësh në pikën më të afërt të grumbullimit. Në

këtë mënyrë qumështi ruhet nga thartimi (rritja e aciditetit), që është pasojë e rritjes së

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Gjatë kësaj periudhe fermerët e frutikulurës (molla) duhet të fillojnë punën e tyre në procesin e krasitjes dimërore, një proces shumë i rëndësishëm dhe i përvitshëm në pemtore nga ku varet prodhim i mollës. Ky operacion kërkon njohuri tekniko-praktike, prandaj çdo fermerë para se të fillojë krasitjen duhet të marrë asistencën teknike të nevojshme nga specialistët e QTTB-së, për të korrigjuar gabimet që mund të jenë bërë ndër vite, por kryesisht për të ruajtur elementet e prodhimit nga viti në vit.

Disa nga udhëzimet tekniko-organizative për fermerët e kultivimit të mollës janë:

- Të kenë njohuri dhe përvojë të mirë praktike mbi krasitjen për kryerjen me efektivitet të këtij procesi shumë të rëndësishëm.

- Të njohë mirë sythat gjenerativë, degëzat e holla, degëzat torbeste, degëzat e përbëra dhe lastarët vegjetativë në kurorë për të vendosur ekuilibrin rritje-frutifikim në kurorën e bimës.

- Para fillimit të operacionit të krasitjes duhet të kryhet dezinfektimi i mjeteve të punës (gërshërë-sharrë), për të penguar transmetimin e sëmundjeve në bimë.

- Krasitësi duhet të ruajë kurorat e pemtoreve në prodhim dhe ti përmirësojë ato me krasitje vit mbas viti, me synim rritjen e ngarkesës me prodhim në kurorë.

- Në ditët me ngrica të ndërpritet procesi i krasitjes, kur temperatura ulen nën -3 grade C, pasi kemi dëmtim në plagët e krijuara nga preje të ndryshme në kurorë, e për rrjedhojë carjen e pareteve qelizore

Këshilla për fermerët e kultivimit të mollës për periudhën e dimrit

dhe mbylljen me shumë vështirësi të tyre.

- Në prerjet shumvjeçare të bëhet lyerja e plagëve me parafinë ose bojë bimore për izolimin e shpejtë të tyre, nëpërmjet krijimit të indit të tapëzimit.

- Të eliminohen degët e thyera dhe ato të infektuara, frutat e mumifikuara në kurorë, gjethet e rëna nën kurorë, të cilat përbëjnë bazën dimërore të sëmundjeve e dëmtuesve për vitin e ardhshëm, ku këto masa merren me qëllim parandalimin e infeksioneve të hershme në pranverë dhe fillim të vegjetacionit të bimëve.



Mbas kryerjes me sukses të operacioneve dimerore të krasitjes së bimëve në pemtore, fermerët duhet të bëjnë spërkatjen e pemtoreve për luftimin e fazave dimërore të sëmundjeve e dëmtuesve. Trajtimet kimike në pemtore janë një masë agroteknike obligative

në pemtore, me të cilën eliminohen një numër i madh i shkaktarëve të sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve frutore.

Zakonisht trajtimet kimike kryhen menjëherë mbas përfundimit të procesit të krasitjes dhe pastrimit të pemtoreve nga mbeturinat bimore të lëna nga krasitja, deri në çelje të sythave që përkon me fundin e muajit Shkurt dhe fillimit të muajit Mars.

Spërkatja duhet të realizohet në kohë të mirë, pa erë dhe me temperatura mbi 10°C. Me spërkatje dimërore ndikohet në mënyrë preventive në bimë, duke zvogluar infeksionet



e mundëshme nga sëmundjet e dëmtuesit dhe ruajtje pastërtinë fitosanitare të pemtoreve.

Për spërkatjen dimërore në pemtore mund të përdorim disa preparate kimike për sëmundjet dhe dëmtuesit, si trajtime preventive në frenimin e shkallës së infektimit në fil-

lim të vegjetacionit në bimë.

1. Hidroksid bakri 50% në formën e bakrit metalik

2. Vaj mineral të parafinuar

3. Clorpirofos me 0.1% etj

Shkaktarë të këtyre sëmundjeve dimërojnë në kurorën e pemëve, në fruta të kalbur dhe në gjethet e rëna në tokë, prandaj behen trajtime dimërore për frenimin e aktivizimit dhe shfaqjes së tyre në bimë.

Në këtë mënyrë zvoglohet potenciali infektues për vegjetacionin e ardhshëm në pemtore. Pema duhet të trajtohet me kujdes, me sasi të mjaftueshme të preparatit në mënyrë të pulverizuar në të gjithë kurorën, në mënyrë që tretësira të prekë të gjitha pjesët drunore në kurorë.

Spërkatësi duhet të përdorë veshje uniforme mbrojtëse si: doreza, syze, kapele, çizme, dhe të lexohet udhëzimi përkatës në etiketën e preparatit kimik mbi përdorimin dhe efektet e mundëshme hemuese të tij. Me spërkatje dimërore eliminohen një numër i madh i insekteve dëmtuese që dimërojnë në të çarat e trungut dhe në pjesë të ndryshme të kurorës së bimëve.

Mos aplikimi i spërkatjes dimërore ose kryerja jo kualitative nuk mund të korrigjohet në pranverë, ku për pasojë do të kemi infeksione që në fazën e parë në pemtore, prandaj duhet të kryhet sipas udhëzimeve agroteknike.

Shënim: Duhet patur kujdes në cilësinë e trajtimit, përgatitjen mirë të tretësirës dhe spërkatjen kualitative për mbulimin e të gjithë pjesëve të kurorës së bimëve.

Drejtoria e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

RRITJA E GJEDHIT DHE ASPEKTE TË RIPRODHIMIT TË GJEDHIT

Rritja e lopës: Udhëzues i plotë për rritjen e lopëve për fillestarët

tojë lopën.

- Trajtimi duhet të jepet derisa të kurohet siç duhet.

- Pas shërimit duhet të siguroheni që nuk ka insekte si morrat, mushkonjat etj.

- Demi duhet të lahet me ujë të përzier me 2.5 lugë çaji "Nusidle" (preparat për pastrimin e lëkurës së gjedhit) për 10 kg

- Duhet të keni kujdes që përzierja e ujit të mos dëmtojë veshin, syrin dhe hundën.

- Prisni për 20-25 minuta pasi të keni aplikuar ilaçin tek lopët.

- Pas kësaj trupi i tij duhet të pastrohet mirë nga sapuni dhe uji i mjaftueshëm.

- Pas dhënies së ilaçeve prisni për tre ditë dhe më pas jepini ushqim të përzier me azot.



Fig. 1 lopët duke kullotur

Rritja e lopës nuk është një ide e re biznesi. Është shumë e vështirë të mbash një familje nga një person në ditët e sotme. Pra, shumë njerëz po mendojnë të bëjnë diçka shtesë. Por nuk ka mundësi, nëse po, ata nuk mund të vendosin se çfarë duhet të bëjnë.

Lopa që rritet mund të jetë një burim i shkëlqyer i të ardhurave për ta. Më së shumti varet nga kostoja e një lope ose çmimi i lopës. Për të blerë lopë për qëllime bujqësore duhet të keni parasysh disa gjëra thelbësore. Për shembull, për qëllime të rritjes mosha e përshtatshme e demit është midis 12-15 muaj.

- Lëkura e demit duhet të jetë e pa dhjamosur dhe e hollë.

- Lopa me peshë të ulët për shkak të ushqimit të pamjaftueshëm mund të blihet me çmim të ulët.

- Duhet të keni parasysh që lopa barëse nuk duhet të sigurojë sanë të përzier me azot.

- Demi i zgjedhur duhet të bëhet i përsosur nga disa trajtime para se të japë sanë të përzier me azot. Nëse demi ka ndonjë vend të plagës, duhet të pastrohet me savlon ose detol në mënyrë që asnjë insekt të mos dëm-

- Duhet të jepet ushqim ushqyes. Ne mund ta bëjmë ushqimin në shtëpi. Ne mund të bëjmë një ushqim të përzier të pasur, të thyer, grurë, puls të thyer etj, si dhe të tjerë për të përzier me azot.

- Procesi i ushqimit të përzier me azot është 10 kg sanë me 10 kg ujë dhe 500 g azot. Duhet të shërbehet në një kuti plastike ose kartoni. Demi duhet t'i jepet 50-60 g azot çdo ditë.

- Ju mund të gjeni më shumë informacione për lopët në institucionin tuaj më të afërt për blegtorinë.

Bari i gjelbër mund të shërbejë sa më shumë që të jetë e mundur. Uji i freskët dhe i pastër duhet të shërbehet sipas kërkesës së tyre. Nëse fermieri mban këtë rregull dhe informacion, atëherë ai mund të jetë i suksesshëm.

Lopët

Lopët janë anëtarë të nën-familjes 'Bovinae' dhe të familjes 'Bovidae'. Kjo familje përfshin gjithashtu Gazelët, Buallët, Bizonët, Antilopat, Delet dhe Dhitë.

Lopët rriten për shumë arsye duke përfshirë:

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

(Vijon nga faqja 11)

qumështin, djathin, produktet e tjera të qumështit, gjithashtu për mish si viçi dhe viçi dhe materiale të tilla si lëkura. Në kohërat më të vjetra ato janë përdorur si kafshë pune për të tërhequr karroca dhe për të lëruar fusha.

Në disa vende të tilla si India, lopët u klasifikuan si kafshë të shenjta dhe u përdorën në ceremonitë fetare dhe u trajtuan me shumë respekt.

Sot, lopët janë shushunja shtëpiake (kafshë me thundra me dy gishtërinj në secilën thundër) që ne i shohim shumë shpesh duke përtypur barin në fushat e fermerëve ndërsa ecim ose vozisim nëpër fshat.

Sot në botë vlerësohet të ketë rreth 1.3 miliard krerë bagëti dhe 920 raca lopësh. Lopët referohen si 'ushqen nënat në racën njerëzore' sepse prodhojnë shumicën e qumështit që pinë njerëzit.

Femra e pjekur e specieve quhet 'lopë'. Mashkulli i pjekur i specieve quhet 'dem'. Një grup lopësh quhet 'tufë'.

Një lopë e re femër quhet 'mëshqerrë'.

Një lopë foshnje quhet 'viç'.

Një lopë kalon deri në 6 orë në ditë duke ngrënë. Lopët kalojnë mbi 8 orë në ditë duke përtypur butën e tyre, e cila është ushqim i reguriguar, pjesërisht i tretur. Lopët pijnë secilën ekuivalente me një vaskë me ujë në ditë.

